



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:039509
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05629976

KPPP.nr.1753/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Avokat D.S. BI me NUI 810944224 me seli në Prishtinë kundër debitorit Banka Kreditore e Prishtinë Zyra e likuidatorit me seli në Prishtinë me NUI 810492728 me seli në rrugën Tirana nr. 30, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.178/22 të datës 21.01.2022 të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjiilan, jashtë seancës me datën 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Banka Kreditore e Prishtinë Zyra e likuidatorit ANULOHET Urdhri Përmbartimor Përmbartimor P.nr.178/22 të datës 21.01.2022 i Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Avokat D.S. BI., ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.178/22 të datës 21.01.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës nr.31/2021 e datës 20.10.2021 me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'i paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 208.00 €, shpenzimet për përpilimin e propozimit të përmbartimit si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore. Ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartuesi privat të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin duke theksuar se dokumenti e besueshëm në bazë të cilit është lëshuar urdhri përmbartimor është jo i ligjshëm dhe jo i bazuar në fakte, lidhur me pretendime se debitori i ka borxh kreditorit shumë prej 208.00 euro nuk qëndron sepse vendimi mbi shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, janë përmbushur në tërësi duke i paguar shumë të tërësishme prej 748.80 euro dhe shpenzime tjera nuk ka pasur, pos tjerash i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar, urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim ku ndër të tjera deklaron se debitori deri në përfundimin e shkallës së parë i është përmbajtur obligimeve ligjore lidhur me pagesën e përfaqësuesit të përkohshëm, ndërsa kreditori pas pranimit të vendimit ka ushtruar ankesë dhe me këtë rast i ka dorëzuar faturën në vlerë prej 208.00 euro debitorit më datën 20.10.2021 për pagesën e shpërblimit të cilin e ka realizuar, ndërsa zyra e likuiditorit nuk e ka përmbushur obligimin i cili rrjedh sipas faturës. Pos tjerash i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, si dhe ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.31/2021 e datës 20.10.2021 në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – fatura nr.31/2021 e datës 20.10.2021 në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori.

Ndërsa nga fletë kthesa postare e cila gjendet në shkresat e lëndës, nga e njëjta nuk mund të konstatohet si dorëzim i rregullt, pasi që nga fletë kthesa konstatohet nënshkrimi i marrësit i dorëzuesit, data 20.10.2021, por te lloji i dërgesës nuk ka shënim se cilat dokumente janë dorëzuar por figuron vetëm “Letrat”, andaj Gjykata në bazë të kësaj fletë kthese nuk mund të konstatoj se ky dorëzim është i rregullt, në mungesë të shënimeve tek lloji i dërgesës, pra nuk mund të vërtetohet se është dorëzuar fatura apo ndonjë dokument tjetër tek debitori.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1753/22, datë 26.04.2024

Gjyqtari
Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.